




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01 Nr.031-296861

Dt.06.12.2016

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë figurative	Zëvendësim	2
2	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë muzikore	Vend i lirë	1
3	ShML	Mësimdhënës/e për informatikë	Zëvendësim	1
4	ShML	Mësimdhënës/e për informatikë	Vend i lirë	3
5	ShML	Mësimdhënës/e për klarinetë	Vend i lirë	1
6	ShML	Mësimdhënës/e për njohje malli ushqimor	Vend i lirë	1
7	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e elektroteknikës (Rregullimi i sinjalit dhe ndriçimit, instalime elektrike, makinat elektrike dhe pajisjet, rrjeta elektrike dhe largpërçues elektrik etj.)	Zëvendësim	1
8	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; Arkitekturë (Konstruktionet ndërtimore, gjeometri dhe perspektivë, kompozicionet arkitektonike, CAD etj.)	Vend i lirë	2
9	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e grafikës (Formësim grafik dhe shkrim, dizajn grafik, histori e artit etj.)	Vend i lirë	1
10	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e ekonomisë	Zëvendësim	1
11	ShML	Mësimdhënës/e nga fusha e ekonomisë	Vend i lirë	1
12	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; Fizioterapi (Kujdesi shëndetësor me rehabilitim, bazat e masazhës, terapia fizikale etj.)	Vend i lirë	1
13	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor; Teknik i farmacisë (Farmakologji me dozologji, hyrje në teknologji farmaceutike, botanikë farmaceutike etj.)	Vend i lirë	1

14	ShML	Mësimdhënës/e për lëndë mjekësore (Edukatë shëndetësore, etika në shëndetësi, kujdesi shëndetësor etj.)	Vend i lirë	1
15	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë fizike	Vend i lirë	1
16	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë fizike	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;**
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore **(nëse ka).**

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHT-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 06/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për edukatë muzikore në shkollë të mesme të ulët:

Fakulteti i Arteve – dega e arteve muzikore – programi pedagogji e përgjithshme muzikore;

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për edukatë figurative në shkollë të mesme të ulët:

Fakulteti i Arteve – dega e arteve të bukura;
 Programi – pikturë
 Programi - skulpturë
 Programi - grafikë

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për edukatë fizike në shkollë të mesme të ulët:

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve;

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për informatikë në shkollë të mesme të lartë:

Fakulteti i edukimit – programi Masteri Mësimdhënies në Teknologji dhe TIK;
 FSHMN – dega shkencat kompjuterike;
 FSHMN – dega e matematikës;

- Niveli Master;
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar);

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë për lëndë mjekësore në shkollë të mesme të lartë:

Fakulteti i Mjekësisë;

- Mjeku specialist;
- Mjeku i përgjithshëm;

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë për klarinet në shkollë të mesme të lartë:

Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës).

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë nga fusha e elektroteknikës në shkollë të mesme të lartë:

MSc. i elektroteknikës – elektroenergjetikë industriale/electroenergjetikë;
Inxh. i diplomuar i elektroteknikës – energjetikë.

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë për arsimor; Arkitekturë në shkollë të mesme të lartë:

Msc. i arkitekturës;
Inxh. i dip. i arkitekturës

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë nga fusha e grafikës, në shkollë të mesme të lartë:

MSc. Akademia e Arteve – dega e grafikës ose dizajnit grafik;
MSc. i grafikës;
Inxh. i dip. – Akademia e Arteve – dega e grafikës ose dizajnit grafik;
Inxh. i dip. grafikës

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë nga fusha e ekonomisë në shkollë të mesme të lartë:

MSc. i ekonomist – profilit përkatës ;
Ekonomis i diplomuar – banka, financa dhe kontabilitet;
Ekonomist i diplomuar – përgjithshëm.

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë për arsimor; Fizioterapi, në shkollë të mesme të lartë:

Master i fizioterapisë:
Fizioterapeut i diplomuar.

Kriteret e kualifikimit për mësime të lartë për arsimor; Teknik i farmacisë, në shkollë të mesme të lartë:

Mr. Ph;
Farmacist i diplomuar.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për njohje malli ushqimor në shkollë të mesme të lartë:

MSc. i teknologjisë ushqimore;
Inxh. i dip. i teknologjisë ushqimore.

SQARIM: Në institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), kandidatët duhet të kenë së paku 300 ETCS, përkatësisht 5 vite studime.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur për institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim të studimeve 4 vjeçar.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunes së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 04.01.2017, por në varësi të liritimit real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **07.12.2016 deri më datën 21.12.2016.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunes së Prishtinës.

Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.